



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 6/2 Prot.

Vlorë më, 29.01.2023

VENDIM

Nr. 50, datë 31.12.2022

PËR

MIRATIMIN E PAGESËS PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË  
MENJËHERSHME PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS PËR PERSONELIN E  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë VKM nr.898, datë 29.12.2022 "Për mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës", si dhe referuar propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr.2069 prot, datë 30.12.2022, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 31.12.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës për 315 punonjës të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Efekti financiar për zbatimin e këtij vendimi është 3,660,000 lekë, i cili do të mbulohet nga fondet e buxhetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin 2022.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

